

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SLK WEB SERVICES" SH.P.K.

Z. Altı Taci, shtetas shqiptar, i biri i Mehmet, lindur më 14.10.1989 në Korçë, dhe banuese në Tiranë, mbajtës i pasaportes me nr. BF8551111 dhe nr. personal I91014037F, madhor me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Edvald Punavia, i biri i Elmazit, shtetas Shqiptar, lindur me 12.08.1986 në Burrel dhe banues në Tiranë mbajtës i dokumentit të identifikimit Leternjoftim nr.034979356, numer personal I60812078E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Znj.Silda Bashalliu, e bija e Adriatikut, shtetase Shqiptare, lindur në Ersekë në 07.10.1989 dhe banuese në Tiranë mbajtës i identifikimit Leternjoftim me nr 035032876, me numer personal I96007049D madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Shtetasit sa më lart, me cilesine e ortakëve themelues të shoqërisë në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, si edhe Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007, Nenet 26, 28, 32 e 35, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", vendosen themelimin e Shoqërisë Tregtare "A.E.J Konstruksion" SH.P.K., shoqëri private e së drejtës shqiptare, krijimi, funksionimi i së cilesë përcaktohet si më poshtë vijon:

KREU I

NENI- 1:

Emertimi i Shoqërisë

- 1.3 Shoqëria do të quhet "A.E.J Konstruksion" Sh.P.K. dhe është person juridik privat i së drejtës Shqiptare, i themeluar dhe do të ushtroje veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 1.4 Veprimtaria dhe funksionimi i kësaj shoqërisë rregullohet sipas neneve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

NENI - 2

ADRESA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë qendrore të saj në adresën: Tiranë, Kashar, Rr.Ndrek Luca ap.10 shk.11, dhe me të drejtë të shtrijës së aktivitetit të saj në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj, nëse do të jetë e nevojshme duke përcaktuar me vone adresat sekondare

NENI 3

Vula e Shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka vullen e saj, përmbajtja e saj do të jetë si vijon: "A.E.J Konstruksion" Sh.P.K.

- 3.2 Te gjitha Aktet dhe Dokumentat qe do te nxjerre Shoqeria drejtuar paleve te treta dhe publikut duhet te tregojne qarte dhe te lexueshem emertimin (llojin) e Shoqerise dhe pas emrit do te jene fjalet **"Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar"** ose shkurtimi sh.p.k.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

4.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **"A.E.J Konstruksion" Sh.P.K.** është veprimtaria në fushën e dhënies së ndihmës juridike e cila do të konsistojë në:

- Punime përfundimtare të ndërtesave dhe punime të fi nicionit

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

6.1. Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm." Kapitali fillestar për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a. Ortaku themelues **Z. Altı Taci** : Zotërues i nje kuote te vetme me vlere nominale 33 (tridhjetetre) leke dhe perfaqeson 33% te kapitalit themeltar.
- b. Ortaku themelues **Z. Edvald Punavia**: Zotërues i nje kuote te vetme me vlere nominale 34 (tridhjetekater) leke dhe perfaqeson 34% te kapitalit themeltar;
- c. Ortaku themelues **Znj. Silda Bashalliu** Zotërues i nje kuote te vetme me vlere nominale 33 (tridhjetete) leke dhe perfaqeson 33% te kapitalit themeltar;

6.2 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet / pakesohet me vendim te Asamblese se ortakeve, duke bere ndryshimet perkatese ne Statut, mbeshtetur ne percaktimet ligjore ne fuqi.

6.3. Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve te vetem te shoqerise sipas perqindjes se zoterimit te kuotes perkatese ne kapital.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

4.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe pa afat.

4.2 Ajo mund shperndahet me vendim te Ortakeve te saj ose te perfaqesuesve te tyre me Prokure te Posacme per shperndarjen e Shoqerise, ose kur shperndarjen e saj e percakton vete legjislacioni ne fuqi

NENI 7

HEQJA DORË

Ortaku Themelues mund të heqe dorë nga Shoqëria, por gjithnjë për shkaqe të përligjura.



Heqja dorë nuk e shkarkon Ortakun Themelues nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

NENI 8

ADMINISTRIMI I FITIMEVE

Fitimi i realizuar kalon në pronësi të ortakeve themelues.

Fitimi është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

NENI 9

ORGANET E SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

Kompetencat e Asamblesë së përgjithshme të Ortakëve dhe të Administratorit i ka Ortaket Themelues .

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Administrator i shoqërisë është: **Z. Edvald Punavia** mbajtes i dokumentit te identifikimit Leternjoftim nr.034979356, numer personal I60812078E, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruarmadhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar ;

NENI 10

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Ortaku i shoqërisë është i detyruar që të ruajnë sekretin e dokumentacionit dhe të informacionit si dhe eksperiencën e realizuar brenda kontekstit të shoqërisë dhe të evitojnë përhapjen e tyre qoftë dhe pjesërisht.

NENI 11

MARDHËNIET E PUNËS

Mardhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit

duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

NENI 12

KONFIDENCIALITETI

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratorët e kësaj shoqërie.

NENI 13

PJESËMARRJA NË SHOQËRI OSE AKTIVITETE TË TJERA

Ortakët Themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera, futjen e personave të tjerë si ortakë të shoqërisë dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkures me atë të shoqërisë së themeluar prej tij.

NENI 14

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 15

LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Nëse shoqëria do të likuidohet atëherë do të caktohet një komision likuidimi që do të parashtrorë një bilanc likuidimi për miratim.

NENI 16

EKSPERTËT DHE REVIZORËT KONTABËL

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizor kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

NENI 17

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

Veprimtaria ekonomike vjetore e shoqërisë do të mbyllet në datën 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakut te vetem dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

NENI 18

DISPOZITA TË FUNDIT

Ndryshimet ne Akt Themelimin e Shoqerise do te behen vetem me vendim shtese me shkrim te Asamblese se Shoqerise

Akti i Themelimit ka vlere ligjore i shoqeruar me Statutin e Shoqerise, te cilet nenshkruhen nga themeluesit e Shoqerise;

Ne rast te mosmarreshjeve me pala te treta apo cdo lloj tjetër mosmarreshjeje, kur keto te fundit nuk zgjidhen ne mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjygesor Tirane.


Akti Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën Shqipe dhe nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË
“ A.E.J Konstruksion”shpk

Alti TACI

Alti Taci


Edvald PUNAVIA

Edvald Punavia


Silda BASHALLIU

Silda Bashalliu
